



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

K.DH.SH.II.nr.1662/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së dytë, me gjyqtarin individual Ramush Bardiqi, në çështjen përmbartimore të kreditorit A.S.T. A.S., e përfaqëson me autorizim Violeta Jashari, avokate nga Prishtina, kundër debitorit të përmbartimit “Florent” Sh.p.k., me seli në Prishtinë, rr. “Vëllezërit Fazliu”, lidhur me çështjen përmbartimore pagesën e borxhit, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.1568/22 të datës 27.09.2023, me datën 20.02.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e debitorit Florent Sh.p.k., me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.1568/22 të datës 27.09.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr.1568/22 të datës 27.09.2023, në piken I të dispozitivit të aktvendimit e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për kthimin e gjendjes e mëparshme i parashtruar nga debitori Florent Sh.P.K., me seli në Prishtinë, për shkak të humbjes së afatit, për paraqitjen e prapësimit kundër urdhërit përmbartimor P.nr.013/2022 e datës 24.01.2022, të përmbartuesit privat Kushtrim Metaj me seli në Prishtinë, ndërsa në piken II të dispozitivit të aktvendimit ka vendosur që ta hedh poshtë prapësimin e debitorit Florent SH.P.K si të pas afatshëm, i parashtruar kundër urdhërit përmbartimorë P.nr.013/2022 e datës 24.01.2022, të lejuar përmbartuesi privat Kushtrim Metaj me seli në Prishtinë.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor debitori ka parashtruar ankesë dhe atë për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës përmbartimore dhe dispozitave të LPK-së, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të shkeljeve të dispozitave materiale, me propozimin që aktvendimi ankimor i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr.1568/22 të datës 27.09.2023, të prishet dhe çështja ti kthehet në rigjykim

gjykatës së shkallës së parë ose të ndryshohet dhe propozimi përmbartimor i kreditorit i cili veç është ekzekutuar të aprovohet në tërësi si i bazuar.

Përgjigje në ankesë, nuk ka paraqitur kreditorit.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (LPP), si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), gjeti se:

Ankesa e debitori është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori A.S.T. A.S., ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit Florent Sh.P.K., në bazë të dokumentit të besueshëm faturave në vlerën prej 34,412.73€, me kamatë ligjore prej 8%, si dhe shpenzimet e procedurës, të gjitha në afat prej 7 ditësh.

Përmbartuesi Privat Kushtrim Metaj me seli në Prishtinë, me urdhrin përmbartimor P.nr.013/2022 e datës 24.01.2022, e ka lejuar përmbartimin ndaj debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm faturave, për shumën e përgjithshme prej 34,412.73€.

Debitori ka paraqitur prapsim me arsyetimin se propozimi nuk paraqet bazë për propozim pasi që debitori ka pranuar urdhërin për lejimin e përmbartimit me datën 26.01.2022 ndërsa kërkesën për kthim në gjendjen e më parshme e ka paraqitur me datën 11.02.2022 për shkak të humbjes së afatit për paraqitjen e prapësimit me arsyetim se urdhëri përmbartimor është nxjerrë më datën 24.01.2022, ndërsa sipas përmbartuesit vëllai i debitori e ka pranuar urdhërin përmbartimore me datën 26.01.2022, duke kundërshtuar se asnjë mënyrë nuk është pranuar nga vëllai i debitorit dhe nuk ka mundur ta pranoj pas që vëllai jeton me prindër dhe gjyshin e tij e që për më tepër debitori i kishte vdekur gjyshi me datën 18.01.2022, për çka e ka pasur të pa mundshme që debitori të merrej me punët e ndërmarrje, prandaj ka propozuar që të aprovohet prapësimi, dhe urdhëri përmbartimor të shfuqizohet.

Përgjigje në prapësim ka parashtruar kreditori, duke kundërshtuar të gjitha pretendimet e debitorit në prapësim dhe ka propozuar që gjykata ta refuzoj prapësimin e debitorit dhe ka kërkuar shpenzimet e paracaktuar sipas Tarifës së Avokateve të Kosovës.

Gjykata Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr.1568/22 të datës 27.09.2023, në piken I të dispozitivit të aktvendimit e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për kthimin e gjendjes e mëparshme i parashtruar nga debitori Florent Sh.P.K., me seli në Prishtinë, për shkak të humbjes së afatit, për paraqitjen e prapësimit kundër urdhërit përmbartimor P.nr.013/2022 e datës 24.01.2022, të përmbartuesit privat Kushtrim Metaj me seli në Prishtinë, ndërsa në piken II të dispozitivit të aktvendimit ka vendosur që ta hedh poshtë prapësimin e debitorit Florent SH.P.K si të pas afatshëm, i parashtruar kundër urdhërit përmbartimore P.nr.013/2022 e datës 24.01.2022, të lejuar përmbartuesi privat Kushtrim Metaj me seli në Prishtinë.

Gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare e duke pasur parasysh neni 129 par.1 të LPK-së fletë dorëzimi i shkresave citon se *“Në qoftëse pala nuk shkon në seancë fare apo e humbë afatin për kryerjen e ndonjë veprimi procedural dhe për këtë shkak e humbë të drejtën që më vonë të kryejë veprimin procedural të lidhur me afat, gjykata do t'i lejojë kësaj pale, me propozimin e saj, ta kryejë më vonë këtë veprim, po që se e konstaton se ekzistojnë shkaqe të arsyeshme të cilat nuk kanë mundur të parashikohen e as të evitohen”*, në rastin konkret duke shqyrtuar kërkesën e kreditorit për kthim në gjendjen e më parshme gjykata vlerëson se i njëjti ka dështuar të argumentoj ekzistimin e shkakut të arsyeshëm si rezultat të cili është pamundësuar të njëjtit që ta ushtroj prapësimin brenda afat ligjor ndaj urdhërin përmbartimor P.nr.3013/22 të datës 24.01.2022. Gjykata ka vlerësuar pretendimin e debitorit se të njëjti, me datë 18.01.2022 i kishte vdekur gjyshi, për çka e ka pasur të pamundur të merrej me punët e ndërmarrjes për të qene koshient, por që këtë rrethanë nuk mundi ta vlerëson si shkak mbi bazën e të cilit mund të lejohet kthimi në gjendje të mëparshme, kjo pasi që procedura përmbartimore sipas propozimit të kreditorit është iniciuar me datë 21.01.2022, pas ndodhjes dhe pushimit të rrethanës së lartcekur dhe atë ndaj debitorit si person juridik, ndërsa debitori ka pranuar urdhrin përmbartimor me datë 26.01.2022, andaj rrethana e paraqitur nga debitori, nuk a filluar të rrjedh përgjatë kohës sa i njëjti ishte dashur ta ushtroj mjetin juridik të prapësimi, andaj gjykata ka vendosur si në pikën I të dispozitivit 5t të këtij aktvendimi duke refuzuar kërkesën për kthim në gjendjen të mëparshme si të pa bazuar.

Gjykata po ashtu ka theksuar se ka vlerësuar edhe pretendimin e debitorit se në rastin konkret kemi të bëjmë me dorëzim të parregullt të urdhrin përmbartimorë, pasi që në kuptim të nenit 110 te LPK-së, urdhëri përmbartimor duhet dorëzuar personalisht palës, por këtë e ka vlerësuar si të pabazuar, kjo për faktin se duke iu referuar nenit 104 te LPK-së me të cilin përcaktohet *“Dërgimi organeve shtetërore dhe personave juridik u behet duke iu dorëzuar shkresat personit të autorizuar për pranimin e tyre apo të punësuarit që gjendet në zyrën, gjegjësisht në lokalit e punës”*, rezulton se urdhri përmbartimor tek debitori si person juridik mund të bëhet edhe tek të punësuarit që gjenden në zyrën e debitorit andaj nuk vlejné rregullat e komunikimit të parapara me nenin 110 te LPK-së kur kemi të bëjmë me persona juridik. Në anën tjetër, Përmbartuesi Privat ka dorëzuar urdhrin në adresën e paraqitur nga debitori në regjistrat publik të ARBK-së, ndërsa debitori nuk ka sjelle prova për të dëshmuar që pranuesi i urdhrin përmbartimor nuk është i ndërlidhur me debitorin. Në këtë drejtim, meqenëse komunikimi me debitorin është konsideruar i rregullt me datë 26.01.2022, ndërsa kërkesa për kthim në gjendje të mëparshme e parashtruar nga debitori rezulton të jetë e pabazuar, atëherë debitori ka mundur ta ushtroj mjetin juridik të prapësimi jo më vonë se me datë 02.02.2022, kjo në kuptim të nenit 70 të LPP-së me të cilin përcaktohet se *“Prapësimi duhet t'i paraditet Gjykatës brenda shtatë (7) ditëve pas pranimit të vendimit përmbartues ose urdhërit përmbartues”*. Meqenëse debitori ka paraqitur prapësimin me nëntë (9) ditë vonesë, pra me datë 11.02.2022, duke iu referuar nenit 73, par. 3 te LPP-së me të cilin përcaktohet se *“Me vendim prapësimi mund te pranohet, refuzohet ose hidhet poshte si i pa afatshëm, si jo komplet dhe i palejuar”* Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi duke e hedhur prapësimin si të pasafatshëm. Prandaj, mbi këtë bazë ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi të atakuar.

Gjykata Komerciale – dhomat e shkallës së dytë vlerëson se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore të parashikuara me nenin 182 par 2 të LPK, për arsye se i njëjti është i kuptueshëm, i qartë dhe se përmban arsye të mjaftuara bindëse faktike dhe juridike mbi faktet vendimtare kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, e të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Për shkak të zbatimit të rregullt të dispozitave të procedurës përmbartimore dhe për shkak të hetimit të rregullt dhe të plotë të gjendjes faktike e cila nuk vihet në dyshim me asnjë pretendim ankimor, gjykata përmbartimore drejtë e ka aplikuar edhe të drejtën materiale aplikimin e drejtë të së cilës gjykata e shkallës së dytë e heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale – dhomat e shkallës së dytë vlerëson se gjykata e shkallës së dytë drejte ka vepruar kur e ka refuzuar si të pabazuar kërkesën mbi kthimin në gjendjen e mëparshme të parashtruar nga ana e debitorit si të pa afatshëm, si dhe kur e ka hedhur poshtë prapësimin e debitorit për shkak të borxhit në shumën prej 34,412.73€ si të pa afatshëm, për arsye se duke u bazuar në dispozitat e nenit 104 të LPK-së përcaktohet se *“Dërgimi organeve shtetërore dhe personave juridik u bëhet duke iu dorëzuar shkresat personit të autorizuar për pranimin e tyre apo të punësuarit që gjendet në zyrën, gjegjësisht në lokalit e punës”*. Prandaj nga kjo dispozite rezulton se urdhri përmbartimor tek debitori si person juridik mund të bëhet edhe tek të punësuarit që gjenden në zyrën e debitorit andaj nuk vlejné rregullat e komunikimit të parapara me nenin 110 të LPK-së kur kemi të bëjmë me persona juridik. Në anën tjetër, Përmbartuesi Privat ka dorëzuar urdhrin në adresën e paraqitur nga debitori në regjistrat publik të ARBK-së, ndërsa debitori nuk ka sjellë prova për të dëshmuar që pranuesi i urdhrin përmbartimor nuk është i ndërlidhur me debitorin.

Andaj, meqenëse komunikimi me debitorin është konsideruar i rregullt me datë 26.01.2022, ndërsa kërkesa për kthim në gjendje të mëparshme e parashtruar nga debitori rezulton të jetë e pabazuar, atëherë debitori ka mundur ta ushtroj mjetin juridik të prapësimin jo më vonë se me datë 02.02.2022, kjo në kuptim të nenit 70 të LPP-së me të cilin përcaktohet se *“Prapësimi duhet t'i paraqitet Gjykatës brenda shtatë (7) ditëve pas pranimit të vendimit përmbartues ose urdhrin përmbartues”*. Në rastin konkret Meqenëse debitori ka paraqitur prapësimin me nëntë (9) ditë vonesë, pra me datë 11.02.2022, duke iu referuar nenit 73, par. 3 të LPP-së me të cilin përcaktohet se *“Me vendim prapësimi mund të pranohet, refuzohet ose hidhet poshtë si i pa afatshëm, si jo komplet dhe i palejuar”* Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij Aktvendimi duke e hedhur prapësimin si të pasafatshëm.

Po ashtu me nenin 130 par.2 të LPK-së përcaktohet se *“Propozimi duhet të paraqitet brenda afatit shtatë (7) ditor nga dita kur ka pushuar shkaku i mosveprimit, e po që se pala më vonë ka mësuar për mosveprimin, atëherë afati llogaritet nga dita kur ka mësuar për mosveprimin”*, ndërsa ne nenin 130 par 3 theksohet se *“ Pas kalimit të gjashtëdhjetë (60) ditëve nga dita e mosveprimit nuk mund të kërkohet kthimi në gjendjen e mëparshme.*

Gjykata Komerciale , Dhomat e shkallës së dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejta ka zbatuar edhe dispozitën e nenit 68 par.2 të LPP-së, ku përcaktohet se “*Kthimi në gjendjen e mëparshme është i lejuar vetëm në rastet e mos ruajtjes së afateve për paraqitjen e prapësimit dhe ankesës kundër vendimeve të përmbarueshëm për përmbarimin me dhunë*”. Prandaj, kjo gjykatë vlerësoje propozimin e debitorit dhe vërtetoje se i njëjti është i pa afatshëm, me arsyetimin së në bazë të shkresave të cilat gjendet në shkresat e lëndës, flete kthesa vërtetohet se debitori propozimin për përmbarim të lejuar me urdhrin përmbarimor e ka pranuar me datën 26.01.2022, kurse i njëjti nuk ka shfrytëzuar të drejtën për të parashtruar mjetin juridike ndaj aktvendimit mbi lejimin e përmbarimit.

Kjo gjykatë, po ashtu vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejte ka vendosur edhe kur ka vendosur si në piken II të dispozitivit, kur e ka hedhur poshtë prapësimin si të pa afatshëm, sepse, në anën tjetër, Përmbaruesi Privat ka dorëzuar urdhrin në adresën e paraqitur nga debitori në regjistrat publik të ARBK-së, ndërsa debitori nuk ka sjelle prova për të dëshmuar që pranuesi i urdhrin përmbarimor nuk është i ndërlidhur me debitorin. Në këtë drejtim, meqenëse komunikimi me debitorin është konsideruar i rregullt me datë 26.01.2022, ndërsa kërkesa për kthim ne gjendje të mëparshme e parashtruar nga debitori rezulton të jetë e pabazuar, atëherë debitori ka mundur ta ushtroj mjetin juridik të prapësimit jo më vonë se me datë 02.02.2022, kjo në kuptim të nenit 70 të LPP-së me të cilin përcaktohet se "*Prapësimi duhet t'i paraqitet Gjykatës brenda shtatë (7) ditëve pas pranimit të vendimit përmbarues ose urdhrin përmbarues*". Në rastin konkret afati i fundit për ngrijën e prapësimit ka qene data 02.02.2022, ashtu që prapësimi i debitorit konsiderohet i pa afatshëm .

Gjykata Komerciale – dhomat e shkallës së dytë i ka shqyrtuar të gjitha pretendimet tjera ankimore, mirëpo të të njëjtat kanë rezultuar si të pathemelta. dhe rrjedhimisht ankesa e debitorit rezulton të jetë e pathemeltë të cilën gjykata ankimore vendosi ta refuzojë, ndërsa aktvendimin e atakuar ta vërtetojë.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 208 dhe 209 pika b) të LPK-së, e në lidhje me nenin 17 të LPP-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,
Dhoma e shkallës së dytë
K.DH.SH.II.nr.1662/23, me datën 20.02.2024

G j y q t a r,
Ramush Bardiqi